



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.05.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ri Tender Furnizim me pajisje të bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë në shkollën profesionale Kadri Kusari", Nr. i prokurimit-632-23-12909-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-23-152-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., e dt.07.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ri Tender Furnizim me pajisje të bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë në shkollën profesionale Kadri Kusari", Nr. i prokurimit- 632-23-12909-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-23-152-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 30.04.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 30.04.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.07.05.2024, Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ri Tender Furnizim me pajisje të bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë në shkollën profesionale Kadri Kusari", Nr. i prokurimit- 632-23-12909-1-2-1, Nr. i brendshëm 632-23-152-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit kontraktues dhe ka dorëzuar dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor, mirëpo Autoriteti kontraktues për të kompletuar kërkesën e përshtatshme të FDT-së, ka kërkuar edhe vërtetimin e gjykatës për pronarin të cilën Operatori ekonomik e ka sjellë brenda afatit.

Pretendimi i juaj i dytë nuk qëndron, sepse mospërputhja e nënshkrimeve të Ardian Osës në deklaratat e dorëzuara për ofertim dhe në deklaratën për zgjatje të vlefshmërisë, nuk është kompetencë e Autoritetit kontraktues.


Pretendimi i tretë gjithashtu nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues, ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe ka kërkuar nga ju sqarime për tenderët jo normalisht të ulëta lidhur me çmimin e paraqitur në pozicionin 5.

Përgjigjja juaj nuk ka qenë specifikisht për pozicionin 5 (siç ju është kërkuar), prandaj për Autoritetin kontraktues kjo përgjigje e juaja nuk ka qenë e mjaftueshme dhe bindëse.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës